



Pranimi / Dorezuar Prilimno / Predato Received / Delivered	29. 01 2021	viti god year	
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/HCU	392/2021		4/13



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.383/2020**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave** në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.383/2020 të datës 03.12.2020 e parashtruar nga ankues.

me adresë rruga "Idriz Gjilani", Lagjja Dardania në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A nr.383/2020, e datës 03.12.2020 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar sipas ndryshim plotësimit të akt emërimit të datës 08.10.2014 në pozitën "Udhëheqës i Divizionit të TI dhe Shërbime Logjistike", në Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit në raportin e auditimit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2019 në pikën 2.1.2 ka konstatuar si shkelje mos pagesën e zyrtarëve sipas vendimit të Qeveris së Republikës së Kosovës Nr.02/39 të datës 08.10.2008.

Ankuesi, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2898/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë



10.12.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 03.12.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 2898/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi Nr.02/39 i datës 08.12.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesa e datës 16.10.2020; Emali zyrtar i datës 02.12.2020; Emali zyrtar i datës 30.11.2020; Emali zyrtar i datës 19.10.2020; Emali zyrtar i datës 01.09.2020; Emali zyrtar i datës 01.09.2020; Emali zyrtar i datës 31.08.2020; Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vitin 2019; Emali zyrtar i datës 14.10.2015; Kërkesa për përgjigje e datës 04.12.2020; Përgjigja në kërkesë e datës 10.12.2020; Ndryshim dhe plotësimi i aktit të emërimit 08.10.2014; Përshkrimi i detyrave të punës i ankuesit i datës 08.10.2014; Kërkesa e datës 16.06.2014; Emali zyrtar i datës 30.11.2015; Emali zyrtar i datës 14.08.2015; Emali zyrtar i datës 17.06.2015; Emali zyrtar i datës 05.08.2015; Emali zyrtar i datës 14.07.2015; Emali zyrtar i datës 30.06.2015; Emali zyrtar i datës 17.06.2015; Vendimi Nr.08/48 i datës 09.09.2015, Vendimi Nr.4/2021, i datës 18.01.2021 i KPMSHCK për vazhdimin e afatit, Kërkesa e datës 29.01.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit *është bërë i pamundur, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 03.12.2020, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 29.01.2021, ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 355/2021 me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 03.12.2020. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër Anr.383/2020**

*Hysni Mustafa*  
*[Signature]*  
Procesmbajtës

*Malsore Cashi Bajraktari*  
*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

